

UDHËZIM
Nr. 423, datë 8.5.2026

MBI PROCEDURAT PËR DIGJITALIZIMIN E HARTAVE KADASTRALE

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 28, germa “ç”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; neneve 9, germa “c”, 10 dhe 15 të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; dhe dokumentit të veprimit “BE-ja për të drejtat e pronës, faza II”, në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së ASHK-së:

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim garantimin e zbatimit të procesit të digjitalizimit të hartave kadastrale përmes unifikimit të procedurës në të gjitha drejtoritë vendore, si dhe sigurimin e kalimit nga hartat fizike në atë digjitale.

2. Procesi i digjitalizimit teknik të hartës kadastrale nis më datë 8 maj 2026 dhe përfundon më datë 7.12.2026 për të gjithë territorin në Republikën e Shqipërisë. Puna për secilën drejtori vendore të ASHK-së do të nisë zyrtarisht sipas planit të punës të dërguar nga kompania kontraktore e ngarkuar për realizimin e këtij procesi.

3. Gjatë procesit të digjitalizimit drejtoritë vendore të ASHK-së:

- a) Pezullojnë dhënien e shërbimeve kadastrale, të cilat kërkojnë veprime në hartën fizike;
- b) Nuk kryejnë korrigjime manuale, apo përditësime, në hartat kadastrale fizike (plansheta).

4. Çdo drejtori vendore cakton person/personat përgjegjës, për:

- a) Monitorimin e procesit të digjitalizimit;
- b) Koordinimin e punës me kompaninë;
- c) Kontrollin e cilësisë së produktit përfundimtar;

5. Drejtoria vendore gjatë procesit vë në dispozicion të kontraktorit hartat fizike të administruara pranë drejtorisë, sipas planit të punës të dërguar nga kontraktori dhe në fund të procedurës firmos procesverbalin për fillimin e procesit me kontraktorin.

6. Me përfundimin e procesit të digjitalizimit planshetat fizike dhe hartat arkivohen sipas legjislacionit në fuqi dhe ndalohet përdorimi i tyre në procese pune.

7. Harta kadastrale digjitale konsiderohet dokumenti i vetëm zyrtar teknik në të cilin pasqyrohen të dhëna mbi pozicionin, përmasat dhe konfigurimin e pasurisë në zonën kadastrale përkatëse.

8. Të gjitha shërbimet që ofrohen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të bazohen vetëm në të dhënat e administruara në mënyrë digjitale dhe për çdo shërbim të kërkuar nga ana e drejtorive vendore do të lëshohet vetëm harta kadastrale digjitale.

9. Drejtoria për Median dhe Marrëdhëniet me Publikun kryen njoftimet sipas planit të komunikimit për fillimin e procedurave të digjitalizimit.

10. Drejtoritë vendore marrin masa për realizimin e procesit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas detyrimeve që burojnë nga kontrata e nënshkruar me kontraktorin.

11. Ngarkohen drejtoritë vendore të ASHK-së për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli